



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Datë: 08.08.2023
Ref. KM-282/23

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) neni 15, Shtojca 11 të Rregullores (QRK)-Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021), dhe Nenin 20 (paragrafët 1, 4 dhe 5) të Ligjit Nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, (Gazeta Zyrtare Nr. 44, datë 22.12.2008) si dhe në bazë të rekomandimit të Komisionit për vlerësim dhe autorizim të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, me Ref.04-382/23, të datës 31.07.2023, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

VENDIM

Për futjen në regjistër dhe lejimin e autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve për përdorim

1. Lejohet importimi, vendosja në treg dhe përdorimi i autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve – **Lumachicda Vebi** i prodhuesit “**Vebi Istituto Biochimico s.r.l.**”, Itali nga përfaqësuesi i saj “**Agrium**”, SH.P.K, Ferizaj.

2. **LLOJI I PRODUKTIT:** Molluscides

3. **PËRMBAJTJA E SUBSTANCËS AKTIVE:** Metaldehyde.....5%

4. PËRDORIMI:

Lumachicda Vebi përmban një substancë të hidhur. Në kopshte perimesh 250/400g për 100m². Në kultura në fushë të hapur 100/300g për 100m². Kryeni trajtimin mundësisht në mbrëmje ose menjëherë pas shiut duke shpërndarë lumachicde vebi në grumbuj të vogël ose në rreshta, duke shmangur ndotjen e pjesëve të ngrënshme. Produkti mund të përdoret në doza dhe në mënyrën e përcaktuar më sipër në kulturat e mëposhme: Marule dhe sallata të tjera, duke përfshirë brassicas (Dolcetta, Marule, Escarole/ Endive, Çikore, Radicchi, Lakërishtë, Barbarea, Rocket, Mustardë e zezë, Brassicaspp. Gjethet dhe filizat duke përfshirë zarzavatet e rrepës, etj); Spinaq dhe të ngjajshme (Spinaq, Chard nga gjethet dhe bregdeti, Portulaca, etj); Barishte të freskëta (Chervil, qiçra, gjethë selino, majdanos, sherebelë, tumë, rozmarinë, trumzë, borzilok, rigon, balsam limoni, nenexhik, mente, gjethë dafine, tarragon, hisop etj); lule dhe ornamentale.

Për kulturat e listuara më poshtë, produkti përdoret në dozat e treguara më sipër ekskluzivisht përgjatë të gjitha skajeve ë fushës, për trajtuar një rrip prej 0,5-1 m, pra jo duke trajtuar drejtpërdrejt të korrat. Perimet me kërcell (Asparagus, Gjembaku, Selino, Kopër, Angjinarija, Prash, Raven, lastarët e bambusë, Zemrat e Palmës, etj).

5. SASIA E AMBALAZHIMIT PËR IMPORTIM:

250g, 500g.

6. VËREJTJE:

Mos e ndotni ujin me produktin ose enën e tij. Karremat duhet të vendosen në mënyrë të tillë që të minimizojnë rrezikun e gëlltitjes nga kafshët e tjera. Duke qenë se ky është një karrem i gatshëm për përdorimin, nuk pritet asnjë përputhshmëri, mos e përzieni me produkte të tjera. Të mos aplikohet nga ajri, te mos shitet me shumicën e zbrazur plotësisht nuk duhet te shpërlahet ne mjedis.

7. KARENCA:

Pezullohet trajtimi 20 ditë para vjeljes.

8. PROPOZIMI I KLASIFIKIMIT:



GHS08-i dëmshëm për shëndetin

9. VENDI I SHITJËS: Në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

10. Produkti për mbrojtjen e bimëve i autorizuar nga pika 1 e këtij vendimi lejohet të importohet në Republikën e Kosovës, deri në afatin siç është përcaktuar në certifikatën e regjistrimit, duke u bazuar ne Databazën e Pesticideve te BE-se/Substancave aktive, ndërsa qarkullimi dhe përdorimi i tij lejohet sipas nenit 26 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve.

11. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Komisioni për vlerësimin dhe autorizimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve;
- Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve;
- Shërbimi kufitar fitosanitar;
- Inspektorët fitosanitar;
- Importuesit të produkteve për mbrojtjen e bimëve;
- Arkivit.

